

Ndërmarrjet shoqërore të Vitisë, borxhlinjtë më të mëdhenj të Komunës

Ibrahim Sefedini

VITI, 12 JANAR – Komuna e Vitisë kapërcen shkallën vjetore të arkëtimit të tatimit, ndërsa problem mbesin borxhet. Kështu ndërmarrjet shoqërore nën menaxhim të AKP-së dhe ndërmarrjet e privatizuara mbesin borxhlinjtë më të mëdhenj të Vitisë. Nga 1.3 milion euro borxhe të grumbulluara në tatimin në pronë, kahas qytetarëve ndërmarrjet shoqërore kanë borxhe 165 mijë euro, të cilat kanë mbetur pa u likuiduar nga AKP-ja. Fadil Abazi, përgjegjës i sektorit të tatin-taksave, ka thënë se me gjithë kapërcimin e planeve në arkëtimin e tatimit në pronë në këta 3 vjetët e fundit, shqetësim i këtij sektori vazhdon të mbetet shuma e madhe e borxheve të grumbulluara nga vitet paraprake, pasi qytetarët, bizneset dhe ndërmarrjet shoqërore i kanë borxhe komunës 1.3 milion euro. “Gjatë këtyre 3 vjetëve, Komuna në tatimin në pronë vazhdimisht ka arkëtarët mjete mbi shkallën e planifikuar, por

megjithëkëtë shuma e borxheve të grumbulluara nga vitet paraprakë mbetet e lartë”, thotë Abazi. Ai theks-on se gjatë 2011-s, Komuna në bazë të faturave vjetore kishte planifikuar arkëtimin e 240 mijë eurove në tatimin në pronë, kurse ka vjelë 260 mijë apo 121.7 për qind, që do të thotë se kahas realizmit të shkallës vjetore ka vjelë edhe rrëth 20 mijë euro borxhe nga vitet paraprakë. “Shqetësim mbetet arkëtimi i borxheve nga ndërmarrjet shoqërore, që janë pa u privatizuar dhe ato të privatizuarat, pasi AKP-ja nuk ka bërë likuidimin e borxheve të tatimit në pronë, ku shuma e tyre është 165 mijë euro”, thotë Abazi. Ai thotë se borxhlinjtë më të mëdhenj nga ndërmarrjet shoqërore janë: ndërmarrja tashti e privatizuar “Vinex” me 48 mijë euro, “Morava e Epërme” me rrëth 50 mijë euro, “Agromorava” me 35 mijë euro dhe Ekonomia e Pyjeve me rrëth 10 mijë euro. “AKP-ja nuk ka paguar asnje cent për tatimin në pronë të ndërmarrjeve të privatizuara dhe atyre që janë në privatizim”, ka thënë

Abazi. Ai ka njoftuar se me gjithë problemet me borxhet e grumbulluara si te qytetarët ashtu edhe te bizneset, sektori i tatin-taksave ka bërë punë të madhe në drejtim të shtrirjes së bazës tatimore në tatimin në pronë, pasi fatura vjetore e tatimit në pronë në Komunën e Vitisë nga 240 mijë sa ishte vitin e kaluar, këtë vit do të jetë 285 mijë euro. “Falë mbështetjes së projektit të Qeverisë zvicerane LOGOS, për 2012 kemi regjistruar edhe 1705 prona të reja, të cilat nuk ishin të regjistruara me çfarë kemi shtrirë bazën tatimore edhe për rrëth 45 mijë euro më shumë që do të thotë shumë për komunën”, ka theksuar Abazi. Ndërsa kryetari i Vitisë, Nexhmedin Arifi, ka thënë se tatimi në pronë mbetet e hyra kryesore e Komunës për realizimin e projekteve të ndryshme të infrastrukturës. “Përmes mjeteve të arkëtuara nga tatimi dhe taksat e tjera komunale, kemi realizuar projektet e trotuareve në Pozheran dhe Drobesh, katin e dytë të shkollës në Ramjan dhe projekte të tjera”, ka thënë Arifi.



Ndërmarrja “Vinex” ka një borxh prej 48 mijë euro, “Morava e Epërme”, 50 mijë, “Agromorava”, 35 mijë dhe Ekonomia e Pyjeve me rrëth 10 mijë euro